



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim B-A / A-B

Ngarkesa: 10 kredite; 100 orë mësimore; Interpretim B-A / A-B (15/85);
Viti / Semestri: Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Kjo lëndë synon thellimin e njohurive të përfuara në ciklin e parë të studimeve në lidhje me nocionet bazë të interpretimit, veçoritë e interpretimit konsektiv dhe simultan, njohjen dhe të kuptuarit e situatës përkthimore si dhe ushtrimin e aftësive pjesore të të dëgjuarit, të analizuarit e të prodhuarit gjuhësor me qëllim realizimin e komunikimit ndërgjuhësor në kombinimin B - A dhe A – B. Gjuha B është gjuha e parë e huaj nga e cila dhe drejt të cilës realizohet interpretimi (në kuptimin e këtij programi gjuhë B konsiderohet gjuha gjermane). Gjuha A është gjuha amtare (në kuptimin e këtij programi gjuhë A konsiderohet gjuha shqipe).

Objektivat specifike lëndore:

1. Të realizojë me saktësi e plotësi kuptimore interpretimin konsektiv dhe simultan nga gjuha B drejt gjuhës A dhe anasjelltas nga gjuha A drejt gjuhës B duke ruajtur nuancat stilistikore të mesazhit, ato me natyrë prozodike si dhe duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore
2. Të realizojë me saktësi e plotësi kuptimore interpretim me përsëritje (chuchotage) nga gjuha B drejt gjuhës A dhe anasjelltas nga gjuha A drejt gjuhës B si formë e veçantë e interpretimit simultan duke ruajtur nuancat stilistikore, ato me natyrë prozodike, duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore
3. Lënda kontribuon në rritjen e kompetencës gjuhësore në gjuhën B si dhe në rritjen e aftësisë së studentëve për punë të pavarur me lloje të ndryshme ligjërimesh.